

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Sintrak", Festivali i Letërsisë e Koreografisë në Tiranë! Georgi Gospodinov e Todor Todorov, në bisedë me publikun - Shqiptarja.com
ADRESA	https://shqiptarja.com/lajm/sintrak-festivali-i-letersise-e-koreografise-ne-tirane-georg-i-gospodinov-e-todor-todorov-ne-bisede-me-publikun
BURIMI	shqiptarja.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 14:51:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 14:49:55 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	11a6467105ddc81f0ee30cefb38a0245c64185464f05bce34931d29a2d582751
TEKSTI	12f2cce4b49fa7855cb92f2b82cbb2ef577febebac62b5d180f9df72590e82ca
PAMJA	f8ebc1c999029048ac5556c6b79434753d06fd2bec3b0ba04a5551954be156fb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4acfcc1351014e511adcf7fbf291525bb5698e8b2bb6a97031d0dd5a14f36b03
E MËPARSHMJA	1616005237807bcb5cf2c0a1521ceee6a70f07e235e862ad3a88be69772198a1
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njëren nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4acfcc1351014e511adcf7fbf291525bb5698e8b2bb6a97031d0dd5a14f36b03>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Zgjedhjet në Rusi/ Dalin rezultatet e para, partia 'Rusia e Bashkuar' e mbështetur nga Putini drejt një fitoreje të thellë



Kultura

"Sintrak", Festivali i Letërsisë e Koreografisë në Tiranë! Georgi Gospodinov e Todor Todorov, në bisedë me publikun

Georgi Gospodinov dhe Todor Todorov janë dy nga të ftuarit më të rëndësishëm të edicionit të parë të Festivalit Ndërkombëtar "Sintrak". Shkrimtari bullgar ka ardhur për lexuesit në një bisedë mbi kujtesën historike.



Blerina Gocë

19 Shtator, 16:46 | Përditësimi: 19 Shtator, 19:13

f Share Tweet



A A

Trupi që kthehet në varg dhe zëri që merr peshë fizike. Kjo është fryma e festivalit ndërkombëtar "Sintrak", i cili po mbahet në kryeqytet, duke bërë bashkë poezinë dhe kërcimin bashkëkohor.

Në ditën e tij të dytë, festivali ka pasur të ftuar shkrimtarin bullgar [Todor Todorov](#).



"Në Ballkan kemi diçka të përbashkët: e përjetojmë modernizimin në mënyrë brutale, ndërsa ruajmë zakone e aspekte groteske. Për mua letërsia e mirë është përtej zhanreve.", tha mes të tjerash Todorov.



[Sh]
.com

LEXO EDHE:
Preç Zogaj: Artisti i mirë, s'tjetërsohet kurrë nga politika!

Në bisedën e tij me Ben Andonin me temë "Arkeologët e Kujtesës ose Historia e Shtypur e Europës", autori bullgar Todorov i ardhur në shqip me romanin "Hagabula" nga përkthyesja Milena Selimi solli një reflektim të thellë mbi qetësinë e Evropës, raportin me natyrën dhe pasojat e shkatërrimit të botës.



"Ajo që konkludojmë është se Evropa gjithmonë është përpjekur të skllavërojë e përdorë të tjerët. Është ajo metafora e Dostojevskit: sikur e gjithë pasuria e botës është mbyllur në një shtëpi qelqi, ndërsa harrojmë se për një kohë të gjatë kemi shkatërruar jetën e njerëzve.", vijoi Todorov.

Ky bashkëbisedim ishte pjesë e festivalit tri-ditor, që solli në Tiranë si të ftuar nderi shkrimtarin [Georgi Gospodinov](#), fitues i Çmimit Ndërkombëtar "Booker Prize 2023", i njohur në shqip me veprat "Roman Natyral", "Fizika e Trishtimit", "Kohëstrehim" dhe "Kopshtari dhe Vdekja", por dhe të tjerë autorë, si: Dinçer Güçyeter, Rita Petro e Manjola Nasi.

Festivali është organizuar për herë të parë nga Qendra e Artit dhe e Librit "Zgjoj" në bashkëpunim me Shkollën e Baletit dhe Qendrën Kombëtare të Fëmijëve në datat 17, 18, 19 shtator.

Sipas Milena Selimit, ideatore e festivalit "Sintrak është vija e thyer ku poezia dhe koreografia bashkëkohore ndërpresin rrjedhën e zakonshme të sistemit. Pa ndjekur rrugët e rrahura SINTRAK krijon një trak të ri, një hapësirë ku zëri merr peshë fizike dhe trupi kthehet në varg. Sintrak është ndërhyrja që çmonton strukturat e vjetra për të lëshuar në skenë një energji të papërpunuar".

Surprizë e festivalit ishin poezitë të lexuara për herë të parë në publik nga Georgi Gospodinov, përkthyer nga Janka Selimi, përkthyesja e parë e Gospodinovit në gjuhën shqipe.

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH
COM

Sondazhi i ditës:

16 Shtator, 14:18

Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?

Të drejtë

Të gabuar

Nuk e di

Lajme të tjera



Festivali i Letërsisë çel siparin. Petro, Dushi dhe Çollaku rrëfejnë poezinë bashkëkohore shqipe (VIDEO)



Valeria Dedaj

6 Tetor 2020, 17:30

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju

Puno me ne

[Shqiptarja.com]

Kërko



© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.